

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pse i kemi çmimet kaq të shtrenjta ?! TVSH e ushqimeve, ndër më të lartat në Europë
ADRESA	https://piranjat.al/social/pse-i-kemi-cmimet-kaq-te-shtrenjta-tvsh-e-ushqimeve-nder-me-te-lartat-ne-i103859
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 06:36:41 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 06:28:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6db23ea2ecb4644ceb09f49eb29fb954aa485cbe72b0fc87133c6ad63b3460ed
TEKSTI	d46d7f9149d2c21d59e3ae6e60b70e9700844a2add39934b5d75500db21d82e
PAMJA	a5863fcb2f1b7acfabf4cabcba9870f62f33e32cd27582e2501172f66244c8e2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	bb8e095e1e5403587b31deea7a09853634dc633a8f0fb9259b82dd549d3a010c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a57398cf8eb56e5c3824c7ad1d9738b2b29a5a5940aff90c94875084de23f115
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/bb8e095e1e5403587b31deea7a09853634dc633a8f0fb9259b82dd549d3a010c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: **blokohet dhe Unaza** do të rrethojnë Krye... ■ **Shkodër, policia në** minuta më parë. Ngjarja ■ **te bandes së policëve** një ndjekje që përfundon ■ **Kruga 130 metra e mbuluar** Beratit, denoncojnë në ■ **duar: Shqiptarët e bashkuar** mbushur plot. Kjo, pasi në

[SOCIALE](#)

Pse i kemi çmimet kaq të shtrenjta ?! TVSH e ushqimeve, ndër më të lartat në Europë

Piranjat Përditësimi i fundit 13 Shtator 2026, 08:28



Qeveria po kërkon ta frenojë shtrenjtimin e ushqimeve përmes "PriceWatch", një platformë që do t'u mundësojë konsumatorëve të krahasojnë çmimet në rrjetet e supermarketeve. Nisma mund të risjell transparencën, t'i ndihmojë familjet të zgjedhin alternativën më të lirë dhe të ushtrojë presion konkurrues mbi tregtarët, por ajo nuk prek drejtpërdrejt kostot që formojnë çmimin.

Pas çmimit të një produkti ushqimor në vendin tonë qëndron një zinxhir i gjatë faktorësh, që nga prodhimi i pamjaftueshëm vendas, varësia nga importet, TVSH-ja 20%, çmimi i lartë i karburantit, transporti, humbjet gjatë shpërndarjes. Në sezonin turistik, këtë zinxhir i shtohen trafiku, vonesat në furnizim dhe një kërkesë që bujqësia vendase nuk po arrin ta ndjekë.

Të dhënat tregojnë se problemi nuk mund të shpjegohet vetëm me shtrenjtimin e mallrave jashtë vendit. Në korrik 2026, sipas Eurostat, çmimet e ushqimeve dhe pijeve joalkoolike në Shqipëri u rritën me 3.2% krahasuar me një vit më parë, teksa rritja mesatare në Bashkimin Europian ishte vetëm 0.6%.

Ushqimet u shtrenjtuan në Shqipëri pesë herë më shpejt se mesatarja europiane. Shqipëria kishte rritjen më të lartë në Ballkanin Perëndimor, përpara Kosovës, ku ushqimet u shtrenjtuan në korrik me 2.7% dhe Malit të Zi, me 2.3%.

Në Serbi, çmimet e ushqimeve ishin 5.6% më të ulëta se një vit më parë, ndërsa në Maqedoninë e Veriut ranë me 0.3%. Kjo ndodhi në një periudhë kur dy faktorë të jashtëm duhej të ndihmonin në uljen e presionit, forcimi i lekut ndaj euros dhe rënia e çmimit mesatar të ushqimeve të importuara.

Përlllogaritjet bazuar në të dhënat e tregtisë së jashtme të INSTAT-it tregojnë se, në shtatë muajt e parë të vitit 2026, çmimi mesatar për kilogram i importeve të grupit "Ushqim, pije dhe duhan" ra me 6.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025. Megjithatë, çmimet që paguan konsumatori vijuan të rriteshin.

Kjo mospërputhje tregon se presioni nuk vjen më vetëm nga tregjet ndërkombëtare. Ai po krijohet gjithnjë e më shumë brenda vendit. Eleni Babameto, e cila zotëron një nga kompanitë më të mëdha të importit dhe shpërndarjes së ushqimeve, "Teuta", thotë se çmimet e larta në Shqipëri janë pasojë e mungesës së prodhimit vendas, barrës fiskale dhe kostove të transportit.

"Ne nuk kemi prodhim të mjaftueshëm vendas dhe as industri ushqimore të zhvilluar, ndërsa kemi një nga normat më të larta të TVSH-së për ushqimet në Europë", thotë ajo.

Sipas znj. Babameto, nga ana tjetër, çmimi i lartë i karburanteve prek çdo hallkë, nga fermeri që punon tokën të përpunuesi, importuesi dhe distributori që furnizon pikat e shitjes. Në këtë situatë, monitorimi mund të ndihmojë për të identifikuar diferencat e pajustifikuara, por nuk mund të zëvendësojë një politikë ushqimore.

Zgjidhja kërkon një paketë të lidhur masash. Alban Zusi, ekspert i çështjeve të bujqësisë që operon në fushën e agroindustrisë, thotë se duhet një analizë për të identifikuar mundësitë për të prodhuar në vend ushqimet që importojmë. Sipas tij, kjo realizohet duke mbështetur të gjithë zinxhirin, që nga prodhimi deri të përpunimi, siç kanë bërë vendet e rajonit.

Rajoni, nga TVSH-ja e ulët te masat ekstra në treg

Një nga arsyt pse çmimet e ushqimeve në vendin tonë janë shumë të larta është TVSH-ja. Shqipëria taton produktet e shportës në nivelin 20%, ashtu si të gjitha mallrat e luksit ose të tjerat që nuk kanë rëndësi jetike.

Krahasimi me Ballkanin Perëndimor e nxjerr Shqipërinë në pozicion të pafavorshëm. Serbia ka të njëjtën normë standarde, 20%, por ushqimet bazë i taton me 10%, sipas legjislacionit tatimor vendas. Në Kosovë, norma standarde është 18%, ndërsa drithërat, mielli, buka, makaronat, vaji i gatimit, qumështi, produktet e bulmetit, vezët dhe kripa taten me 8%.

Mali i Zi ka normë standarde 21%, por për bukën, miellin, qumështin dhe produktet e bulmetit përdor normën e reduktuar 7%.

Në Maqedoninë e Veriut, norma standarde është 18%. Ushqimet bazë taten me 5%, ndërsa disa kategori të tjera ushqimore me 10%. Norma 5% përdoret edhe për ushqimin e kafshëve dhe për një pjesë të materialeve e pajisjeve bujqësore.

Bosnjë-Hercegovina nuk ka normë të reduktuar, por norma e vetme prej 17% është tri pikë përqindje më e ulët se ajo që Shqipëria aplikon mbi ushqimet.

Por, përveç TVSH-së më të ulët, vendet e rajonit kanë marrë masa ekstra për frenimin e rritjes së çmimeve pas pandemisë.

Pas valës së inflacionit që nisi në vitin 2021 dhe u përshpejtua në vitin 2022, me rritjen e çmimeve të energjisë dhe ushqimeve, vendet e Ballkanit Perëndimor ndërhyjnë me masa të jashtëzakonshme për të frenuar koston e jetesës. Më vonë, sidomos pas vitit 2024, disa qeveri kaluan drejt kufizimit të marzheve të fitimit, duke synuar të ulnin çmimet pa krijuar mungesa në treg. Maqedonia e Veriut ishte ndër vendet që ndërhyri më fort. Gjatë kulmit të krizës, në vitet 2022-2023, qeveria ngriu çmimet e disa produkteve bazë, si buka, qumështi, makaronat dhe vezët.

Në shkurt 2025, masa u ndryshua drejt një modeli më fleksibël, me kufizim të marzhit të fitimit deri në 10% në tregtinë me shumicë dhe pakicë për 73 grupe produktesh ushqimore. Kosova ndoqi një qasje të ngjashme me çmime tavan për produktet e shportës bazë. Pas rritjes së fortë të çmimeve, qeveria miratoi në parim ligjin për kufizimin e çmimeve për produkte si drithërat, mielli, vaji ushqimor, vezët dhe produktet higjienike.

Paralelisht, u forcuan kontrollet e Inspektoratit të Tregut mbi marzhet e importuesve të mëdhenj dhe marrëveshjet që mund të çonin në abuzime. Mali i Zi e zhvendosi fokusin kryesisht te kufizimi i marzheve. Pas disa ndërhyrjeve gjatë periudhës 2024-2025, qeveria zgjeroi listën e produkteve me çmime të kufizuara në mbi 70 kategori, përfshirë mishin, bulmetin, vajin, miellin, perimet dhe ushqimet për fëmijë. Marzhi i fitimit u kufizua në 5% për shitësit me shumicë dhe 7% për shitësit me pakicë, ndërsa masat u shtynë deri në fund të marsit 2026.

Serbia përdori fillimisht një kombinim rezervash shtetërore dhe marrëveshjesh me supermarketet. Në vitet pas krizës, qeveria ndërhyri me rezerva për produkte si mielli dhe vaji, ndërsa më pas nxiti fushata si “Çmimi më i mirë”, në bashkëpunim me rrjetet e tregtisë, për uljen e çmimeve të produkteve të përditshme.

Kjo qasje solli rënie të çmimeve të ushqimeve në mesin e vitit 2026, sipas të dhënave të cituara për rajonin. Në Bosnjë-Hercegovinë, masat u zbatuan në mënyrë të fragmentuar, për shkak të ndarjes administrative të vendit. Të dy entitetet vendosën kufizime të marzheve për produktet e shportës bazë. Në Republikën Srpska, masat u shtynë deri në fund të vitit 2025, me synimin për të mbajtur nën kontroll çmimet e produkteve më të domosdoshme.

Shqipëria ndërhyri kryesisht në vitin 2022, përmes bordeve të transparencës për ushqimet bazë dhe karburantet, si dhe paketave sociale për shtresat më të prekura nga rritja e çmimeve.

Por, ndryshe nga disa vende të rajonit, aktualisht nuk ka një mekanizëm të gjerë aktiv për kufizimin e marzheve të fitimit në produktet ushqimore. Mungesa e prodhimit vendas, shkak për çmime të larta

Konsumi dhe zgjerimi i turizmit kanë krijuar një treg ushqimor më të madh. Por bujqësia dhe industria përpunuese nuk po furnizojnë dot sasi të qëndrueshme, me standard të njëjtë dhe në kohën që kërkojnë supermarketet, hotelet dhe restorantet. Hendeku po mbulohet me importe. Të dhënat e INSTAT-it për tregtinë e jashtme tregojnë se, gjatë periudhës janar–korrik 2026, Shqipëria importoi rreth 239.3 mijë tonë drithëra, 23.1% ose 44.9 mijë tonë më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Vetëm drithërat përbënin rreth 39.5% të sasisë së përgjithshme të ushqimeve të importuara.

Importet e perimeve dhe zarzavateve u rritën me 11.1%. Për produktet e bulmetit, vezët dhe mjaltin, sasi të importuara u shtuan me 6.8%, në 21.6 mijë tonë. Importet e frutave dhe arrave u rritën me 5.1%. Ka ndryshuar edhe harta e furnizuesve. Importet nga Serbia ranë me 15%, ndërsa u shtuan furnizimet nga Kroacia dhe Moldavia, kryesisht për drithërat.

U rritën gjithashtu importet nga Ukraina, Maqedonia e Veriut dhe Greqia. Për mishin dhe frutat ekzotike, tregu u orientua më shumë drejt Brazilit, Argentinës dhe Ekuadorit. Sa më shumë ushqime të vijnë nga jashtë, aq më i ekspozuar bëhet tregu ndaj transportit, kursit të këmbimit, luhatjeve ndërkombëtare dhe ndërprerjeve të furnizimit.

Shqipëria nuk mund të i zëvendësojë të gjitha importet ushqimore. Por mund ta ulë varësinë në kategoritë ku ka avantazh, është shprehur Alban Zusi. Potencialin më të madh e kanë perimet, zarzavatet dhe disa lloje frutash. Prodhimi i perimeve arriti në më shumë se 1.44 milionë tonë në vitin 2025, por importet e tyre u rritën sërisht me 11.1% në shtatë muajt e parë të vitit 2026.

Hotelet, restorantet dhe supermarketet kërkojnë furnizim të vazhdueshëm, kalibër të njëjtë, paketim, certifikim dhe faturim. Gjithashtu, te bulmeti dhe mishi, potenciali për rritjen e prodhimit është i pranishëm nëse jepen subvencione. Ringritja e blegtorisë kërkon pagesa për krerë, financim për shtimin e tufave, prodhim ushqimi për kafshët, stalla, veterinarinë, përpunimin dhe kontrata blerjeje.

Te drithërat, mundësia e zëvendësimit të importeve është më e vogël. Shqipëria nuk konkurren lehtë me sipërfaqet e mëdha dhe prodhimin e mekanizuar të Serbisë, Ukrainës apo Kroacisë. Politika duhet të përqendrohet te siguria e furnizimit, rezervat dhe diversifikimi i partnerëve, jo te një objektiv jorealit vetëmjaftueshmërie.

Nga viti 2020, çmimet e ushqimeve të importuara rritën me 40% Çmimi mesatar për kilogram i importeve të grupit “Ushqim, pije dhe duhan” ishte relativisht i qëndrueshëm gjatë viteve 2015–2020.

Përlllogaritjet e “Monitor”, të kryera si raport i vlerës së importuar me peshën neto të raportuar nga INSTAT-i, tregojnë se çmimi mesatar ishte 99.63 lekë për kilogram në vitin 2015. Brenda gjashtë viteve, çmimi kishte lëvizur në një interval të ngushtë prej rreth 97–101 lekësh. Goditja e fortë nisi në vitin 2021. Çmimi mesatar u rrit me 16.3%, në 117.96 lekë për kilogram. Në vitin 2022 pasoi një tjetër rritje, këtë herë me 23.9%, duke e çuar mesataren në 146.12 lekë, nivelin më të lartë të periudhës.

Krahasuar me vitin 2020, kostoja mesatare e një kilogrami ushqime, pije dhe duhan të importuar ishte rritur me rreth 44%. Pas kulmit të vitit 2022, presioni nisi të zbehej. Në vitin 2023, çmimi mesatar ra me 11.2%, në 129.77 lekë për kilogram. Në vitin 2024 zbriti me 6.9%, në 120.85 lekë, ndërsa në vitin 2025 u regjistrua një rënie e lehtë prej 0.4%, në 120.37 lekë.

Në shtatë muajt e parë të vitit 2026, çmimi mesatar ishte 115.57 lekë për kilogram, rreth 6.5% më i ulët se në të njëjtën periudhë të vitit 2025. Por goditja nuk është zhbërë. Edhe pas rënies, çmimi mesatar i importit mbetet rreth 14% mbi nivelin e vitit 2020 dhe afërsisht 16% më i lartë se në vitin 2015.

Një pjesë e vonesës në uljen e çmimeve të konsumit mund të lidhet me kontratat afatgjata, rezervat e blera më herët dhe kohën që kërkon transmetimi përgjatë zinxhirit. Por fakti që çmimi mesatar i importit po bie, ndërsa ushqimet në tregun vendas po shtrenjtohen, tregon se kostot e krijuara brenda Shqipërisë kanë marrë rol më të madh.

Karburantet dhe logjistika e kushtueshme

Çmimi i karburanteve prek çdo hallkë të zinxhirit ushqimor. Fermeri përdor naftë për mekanikën bujqësore, përpunuesi paguan transportin e lëndës së parë; importuesi mbulon lëvizjen nga porti ose pika kufitare, distributori furnizon magazinat dhe pikat e shitjes. Aktualisht, një litër naftë po shitet me 219 lekë për litër, niveli më i lartë në rajon dhe Europë.

Edhe kur produkti blihet më lirë jashtë vendit, transporti nga kufiri në magazinë dhe më pas te rrjetet e shitjes mund ta zbejë përfitimin. Sipas znj. Babameto, mangësitë e logjistikës bëhen veçanërisht të dukshme gjatë sezonit turistik. Kamionët që furnizojnë zonat bregdetare mund të qëndrojnë për orë të tëra në trafik. Vonesat shtojnë konsumin e karburantit, orët e punës dhe rrezikun e humbjeve për produktet e freskëta.

Kompanitë do të përballen edhe me kosto të tjera nga procesi i integritimit europian. Standardet për sigurinë ushqimore, gjurmueshmërinë, magazinimin dhe transportin kërkojnë investime në mjedise, pajisje dhe teknologji. Këto investime janë të domosdoshme për cilësinë, mbrojtjen e konsumatorit dhe eksportet. Por nëse bizneset nuk mbështeten me financim të përshtatshëm, një pjesë e koston mund të kalojë në çmimet përfundimtare.

TVSH-ja e lartë, BE-ja e trajton ushqimin si nevojë bazë

Distributorët e ushqimeve u shprehën se TVSH-ja e lartë është shkaku kryesor për çmimet e larta të ushqimeve. Babameto tha se Shqipëria duhet ta ulë prapen për ushqimet e shportës, pasi tregu tani është i fiskalizuar dhe procesi është më i monitorueshëm.

Shqipëria nuk është e detyruar ta mbajë TVSH-në mbi ushqimet në nivelin 20% për t'u përafëruar me Bashkimin Europian. Përkundrazi, kuadri europian krijon hapësirë për norma më të ulëta.

Sipas Komisionit Europian dhe Direktivës së TVSH-së, shtetet anëtare mund të përdorin deri në dy norma të reduktuara, jo më të ulëta se 5%, për kategori të përcaktuara. Direktiva lejon gjithashtu një normë nën 5% dhe një normë zero për një numër të kufizuar kategorish që plotësojnë nevojat bazë, ku përfshihen ushqimet.

Në praktikë, pjesa më e madhe e vendeve të BE-së përdor norma të reduktuara. Gjermania aplikon 7%, Franca 5.5% për shumicën e ushqimeve, Holanda 9% dhe Greqia 13%. Italia përdor norma të diferencuara 4%, 5% dhe 10%, Kroacia 5% dhe 13%, ndërsa Polonia 5% dhe 8%, në varësi të produktit.

Luksemburgu zbrit deri në 3% për kategori të caktuara. Danimarka është ndër përjashtimet e pakta. Ajo nuk përdor normë të reduktuar dhe i taton ushqimet me normën standarde 25%.

Shembulli më i fundit i përdorimit të TVSH-së si instrument kundër kostos së jetesës vjen nga Suedia. Nga prilli 2026, qeveria suedeze e uli përkohësisht normën mbi ushqimet nga 12% në 6%, me parashikimin që masa të qëndrojë në fuqi deri në fund të vitit 2027.

Në shtator, Reuters raportoi se, sipas vlerësimit të Agjencisë Suedeze të Konsumatorit dhe Institutit Kombëtar të Kërkimeve Ekonomike, ulja ishte transmetuar në çmimet e shitjes me pakicë. Përvoja suedeze tregon dy gjëra. Së pari, TVSH-ja mund të përdoret për të lehtësuar familjet. Së dyti, ulja duhet të shoqërohet me monitorim, në mënyrë që përfitimi të kalojë te konsumatori dhe të mos mbetet te marzhet e tregtisë.

Znj. Babameto tha se, për Shqipërinë, një ulje e përgjithshme për të gjitha ushqimet do të favorizonte në vlerë absolute edhe familjet me konsum të lartë. Alternativa më e arsyeshme do të ishte një shportë e kufizuar me bukë, miell, oriz, qumësht, vezë, vaj dhe produkte të tjera bazë, e shoqëruar me raportim të çmimeve para dhe pas ndryshimit.

Pikërisht këtu “PriceWatch” mund të marrë një funksion real, jo thjesht të krahasojë supermarketet, por të kontrollojë nëse lehtësimi fiskal kalon te qytetari.

Çmime europiane, të ardhura shumë më të ulëta

Paradoksi shqiptar nis nga raportin ndërmjet çmimeve dhe të ardhurave. Sipas të dhënave të Eurostat për nivelet krahasuese të çmimeve, në vitin 2025, indeksi i çmimeve të ushqimeve dhe të pijeve joalkoolike në Shqipëri arriti në 103.8, me mesataren e Bashkimit Europian të barabartë me 100.

Kjo do të thotë se një shportë ushqimore që kushton mesatarisht 100 euro në BE kushton rreth 104 euro në Shqipëri. Një vit më parë, niveli shqiptar ishte 99.6% e mesatares europiane. Nga ana tjetër, të ardhurat për frymë në Shqipëri mbeten rreth 43% e mesatares së BE-së, ndërsa konsumi individual aktual, një tregues që pasqyron më mirë mirëqenien materiale të familjeve, arrin në

atersisht 48% te mesatares se BE-se.

Pesha që ushqimet kanë në buxhet e bën çdo rritje më të ndjeshme. Sipas peshave të publikuara nga INSTAT-i, ushqimet dhe pijet joalkoolike përbëjnë 34.6% të shportës së Indeksit të Çmimeve të Konsumit. Në korrik 2026, inflacioni i përgjithshëm i matur me Indeksin e Çmimeve të Konsumit arriti në 3.4%, nga 2.5% një vit më parë. Ushqimet dhanë 1.09 pikë përqindje, ose afërsisht një të tretën e rritjes së përgjithshme të çmimeve.

Shtrenjtimi nuk shpërndahet në mënyrë të barabartë. Një familje me të ardhura të ulëta, që shpenzon gjysmën e buxhetit për bukë, qumësht, mish, vaj, perime dhe fruta, goditet shumë më fort se një familje ku ushqimet zënë vetëm një të pestën e shpenzimeve. Hendeku dallohet veçanërisht nga emigrantët që kthehen në Shqipëri dhe kanë mundësi t'i krahasojnë drejtpërdrejt tregjet.

Ferdinand Xhindoli, nga Durrësi, u kthye me bashkëshorten pas 33 vitesh emigracion në Itali. Ai thotë se gjatë vitit të fundit ka vërejtur një rritje të vazhdueshme të çmimeve.

“Në një supermarket në Itali bëra rreth 80 euro blerje. Të njëjtat produkte në Shqipëri do të më kushtonin afërsisht 120 euro”, thotë ai. Sipas z. Xhindoli, kostoja e jetesës mund të kthehet edhe në pengesë për kthimin e emigrantëve.

“Thuhet që emigrantët të kthehen, por nëse nuk merren masa dhe vendime sa më shpejt, nuk besoj se shumë prej tyre mund ta përballojnë kthimin me këto çmime”, shprehet ai. /Monitor

Artikuj te sugjeruar

SOCIALE 11 Shtator13:00

[Rritet emigrimi, 69 mijë shqiptarë morën leje qëndrimi në BE në 2025](#)

Tendenca e emigracionit është përshpejtuar sërish vitin e fundit, sipas të dhënave indirekte nga Eurostat, që raporton leje...

SOCIALE 11 Shtator09:43

[Inflacioni 3.2% në gusht, transporti dhe ushqimet ndikojnë në rritjen e çmimeve](#)

Inflacioni në Shqipëri u rrit në 3.2% në gusht 2026, duke shënuar një përshpejtim të ndjeshëm krahasuar me të...

SOCIALE 11 Shtator07:13

[Të rinjtë ikin, por dhe ata që mbeten nuk kanë ku punojnë, papunësia e tyre rritet 16%](#)

Shqipëria po humbet popullsi dhe veçanërisht të rinj, por tkurrja e kësaj grup-moshe nuk po shoqërohet me një lehtës...

SOCIALE 10 Shtator23:51

[Denoncimi nga Tropoja/ Banori i fshatit Geghysen: Rruga në gjendje të degraduar, fondet i devijuan për një rrugë tjetër](#)

Një banor nga fshati Geghysen i Tropojës ka ngritur shqetësimin për gjendjen e rrugës në fshatin e tij që e lidh atë m...

SOCIALE 10 Shtator18:29

[Zjarret/ ISHP: Tymi ka ndikim në shëndetin publik të grupeve në risk](#)

Shqipëria po përballet prej disa muajsh me vatra të vazhdueshme zjarri. Veç impaktit mjedisorë, specialistët e ISHP thonë s...

SOCIALE 10 Shtator17:30

[SKANDAL/ Vidhen 160 mijë dollarët e dhuruara për nënën dhe djalin me spektrin autik](#)

Rasti i nëna File dhe djalit me spektrin autik, Andi, preku zemrat e shqiptarëve gjatë muajit korrik. Nëna dhe djali i saj 19-vjeçar,...

SOCIALE 10 Shtator07:04

[Azilet kërkojnë staf jashtë vendit, filipinasit dhe tunizianët pritet të kujdesen për të moshuarit](#)

Shqipëria po përballet me mungesë gjithnjë e më të theksuar të fuqisë punëtore për shumë sektorë t...

SOCIALE 9 Shtator14:04

[AAPSK: Të ardhurat nga qiratë e pasurive të sekuestruara rriten me 30%, afro 2 mln euro në 8 muaj](#)

Të ardhurat që shteti siguron nga dhënia me qira e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara kanë shënuar një rritje t...

SOCIALE 9 Shtator14:05

[Rezultati i PISA-s/ Studiuesi: Të dhënat e Shqipërisë me sinjal të kuq! Dyshohet se janë fasifikuar](#)

Studiuesi Taulant Muka ka reaguar lidhur me rezultatet e Shqipërisë në raportin PISA 2025, duke ngritur shqetësime mbi mënyrën e...

SOCIALE 9 Shtator13:26

[Mishi i pulës që shkakton tumor, antibiotiku i përdorur te shpendët në Brazil shkakton probleme serioze në shëndet](#)

Konsumimi i mishit të pulës me antibiotik përbën një rrezik serioz për shëndetin e njeriut, pasi mbetjet e medikamenteve ve...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 12 Shtator

[EMRI- 2.4 mln euro kokainë në trëndafila/ Kush ...](#)

Personi i arrestuar në Greqi si kreu i grupit të trafikut të kokainës nga Kolumbia përmes trëndafilave është Lulzim Cak...

AKTUALITET 12 Shtator

[Pritë me armë në Greqi, 'policët' e rremë bllok...](#)

Një arratisje spektakolare ka ndodhur mbrëmjen e së premtes në Greqi, gjatë transferimit të një të burgosuri nga Burgu...

Nga Elton Qyno AKTUALITET 12 Shtator

["Bëmë takim familjar"-Flet Ziza Pajaziti: Ja si...](#)

Modelja kosovare Ziza Pajaziti, e cila në datat 12 dhe 13 qershor 2025 rezulton të ketë hyrë në ambientet e burgut të siguris&eu...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Reagon Cllevio!



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.